



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 1/95  
Datë: 17/5/2022

Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës, mbështetur në nenin 12 të Rregullores me nr. prot. 1/55, datë 12.5.2022, për procedurën zgjedhore, themelimin dhe punën e Parlamentit Studentor dhe Këshillave të studentëve të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", në vazhdimin e mbledhjes së datës 12.5.2022, mbajtur më 16.5.2022, mori:

**V E N D I M**

- I. Emërohet Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ-UP) për organizimin e zgjedhjeve të studentëve në nivel të përfaqësimit në Parlamentin e Studentëve dhe të Këshillave të studentëve të fakulteteve në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina".
- II. Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ-UP), emërohet në këtë përbërje:
  1. Prof. asoc. dr. Florent Muçaj - kryesues;
  2. Prof. dr. Hysni Osmani - zv. kryesues;
  3. Besfort Krasniqi - sekretar;
  4. Nga një përfaqësues prej të gjitha organizatave të studentëve të cilat janë të certifikuar për zgjedhje, në cilësinë e vëzhguesit pa të drejtë vote;
  5. Një përfaqësues nga Komisioni Qendror Zgjedhor i Republikës së Kosovës, në cilësi të monitoruesit, pa të drejtë vote.
- III. KQZ-UP do t'i përmbushë obligimet e veta sipas Ligjit nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë, Statutit të Universitetit të Prishtinës dhe rregulloreve në fuqi.
- IV. KQZ-UP është përgjegjës për organizimin dhe mbikëqyrjen e zgjedhjeve studentore në përputhje me Rregulloren me nr. prot. 1/55, datë 12.5.2022, për procedurën zgjedhore, themelimin dhe punën e Parlamentit Studentor dhe Këshillave të studentëve të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina".
- V. Procedura pas përfundimit të parakohshëm të mandatit të përfaqësuesit të studentëve në Parlamentin e Studentëve dhe Këshillat e studentëve zbatohet nga sekretari i KQZ-UP (sekretari i përgjithshëm) për Parlamentin e Studentëve dhe kryesuesi i KZF (sekretari i fakultetit) për Këshillat e studentëve.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Këshilli Drejtues.

**Vendimi t'u dërgohet:**

1. Arkivit të UP-së,
2. Sekretarëve të fakulteteve,
3. Organizatave studentore,
4. Anëtarëve të KQZ-së,
5. Për publikim në uebfaqe.



Këshilli Drejtues i UP-së

Dr. Arbëresha Nela-Turjaka, kryesuese